



z Pd 40

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT E TË**  
**KOMUNIKIMIT**

**UDHËZIM**

Nr. 2 datë 2 / 9 /2013

**PËR**

**STANDARDIZIMIN E HARTIMIT TË TERMAVE TË REFERENCËS**  
**PËR PROJEKTET TIK NË ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të shkronjës "ç", të Kreut XI, të Vendimit nr.1, datë 10.01.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, të shkronjës "dh" dhe "e" të pikës 3, të Vendimit nr.248, datë 27.04.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar, dhe të shkronjës c, pika 1 e Vendimit nr. 710, datë 21 gusht 2013, të Këshillit të Ministrave "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit",

**U DHË Z O J:**

**I. Të përgjithshme**

1. Ky udhëzim mbështetet në modelet dhe praktikat më të mira europiane, për zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), dhe në veçanti të qeverisjes elektronike, për lehtësimin e punës dhe

ofrimit të shërbimeve on-line për qytetarët, biznesin dhe vetë administratën publike.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është që institucionet e administratës publike, në praktikën e tyre të punës, të udhëhiqen nga zbatimi i standardeve dhe rregullave për zhvillimin dhe implementimin e projekteve të e-Qeverisjes.
3. Ky udhëzim përcakton parimet, kërkesat dhe procedurën që ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të termave të referencës për:
  - Projektet TIK për sisteme informacioni të reja (*hardware* dhe *software*);
  - Mirëmbajtje e sistemeve të informacionit ekzistuese (*hardware* dhe *software*);
  - Kërkesë për blerjen e pajisjeve hardware TIK.
4. Ky udhëzim zbatohet nga institucionet e administratës publike, në nivel qendror, ku përfshihen aparatet e Kryeministrisë dhe të ministrive, degët e ministrive, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit dhe ministrave të linjës, degët e tyre si dhe administrata e prefektit.
5. Rekomandohen institucionet qendrore të pavarura, duke përfshirë ato të sistemit gjyqësor e të prokurorisë, të universiteteve shtetërore, si dhe të fondeve speciale, Njësitë e Qeverisjes Vendore, të zbatojnë këtë udhëzim gjatë hartimit të projekteve të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, për institucionet e tyre.
6. Ky udhëzim nuk zbatohet për ato projekte TIK, për sisteme, rrjete informatike dhe/ose rrjetet e pajisjet e transmetimit në lidhje me informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror".
7. Gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK të administratës publike, duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme:
  - a) Cilësia: Projektet duhet gjithmonë të ofrojnë zgjidhjet e shërbimit dhe të dorëzohen në një mënyrë profesionale dhe efikase.
  - b) Transparency: TIK duhet të përdoret si një instrument për të promovuar transparencën dhe efikasitetin në proceset e punës të administratës publike, si edhe, për të ndihmuar në reduktimin e korruptionit.
  - c) Siguria: Niveli i sigurisë, masat, praktikat dhe procedurat për sigurinë e sistemeve të informacionit duhet të koordinohen dhe të integrohen me njëra tjetrën si dhe me praktikat e procedurat administrative në mënyrë që të krijohet një sistem sigurie koherent.

- d) Afatet kohore: Projektet duhen përfunduar në kohë dhe, kur është e nevojshme, shtesat dhe rregullimet kohore duhen të bëhen përmes një procesi të kujdeshshëm.
- e) Puna në grup: Të gjithë anëtarët e grupit ë punës të projektit duhet të punojnë së bashku, të ndajnë njohuritë dhe informacionin, dhe të bashkëpunojnë për të ofruar projekte cilësore.
- f) Konsistenca: Projektet duhet të menaxhohen në një mënyrë të qëndrueshme për të maksimizuar produktivitetin e personelit duke përfituar nga përvojat e mëparshme.
- g) Vlera e punës: Të gjitha projektet, pavarësisht nga madhësia apo fushëveprimi, duhet të jenë të lidhura me objektivat institucionale dhe synimet e strategjisë sektoriale dhe kombëtare.
- h) Komunikimi: Projektet duhet të menaxhohen për të siguruar që të gjitha palët të jenë të informuara vazhdimisht për problemet, progresin dhe ndryshimet e bëra, për të siguruar kështu mbështetjen dhe pjesëmarrjen efektive.
- i) Fleksibiliteti: Praktikat e menaxhimit të projektit duhet të strukturohet për tu përshtatur nevojave organizative dhe kapaciteteve, si dhe kërkesave të projektit.
- j) Neutraliteti i teknologjisë: Projektet duhet të reflektojnë parimet e neutralitetit teknologjik.

## **II. RREGULLAT E HARTIMIT DHE PROCEDURA E MIRATIMIT TË TERMAVE TË REFERENCËS**

8. Për propozimet e kérkuara, institucionet gjatë hartimit të termave të referencës për projektet TIK, duhet të marrin në konsideratë çështjet si më poshtë:

- a) të identifikojnë një "sistem të hapur" si një kërkesë minimale standarde. Duhet të krijohet infrastruktura e nevojshme e lidhjes për të mbështetur një rrjet të qëndrueshëm të zhvillimit si dhe kapacitetin e menaxhimit të rrjetit për të mbështetur proceset e rrjetit.
- b) të përfshijnë detajet teknike mbi konvertimin e të dhënave në një bazë të dhënash digitale, duke përfshirë menaxhimin e një konvertimi të tillë, migrimit të bazës së të dhënave, trajnimin dhe aftësinë për të vazhduar

projektin. Kostot e shoqëruara me këto aktivitete do të formojnë pjesë të kostos totale të projektit të propozuar.

- c) të përfshijnë nivelin e sigurisë, identifikimin e disponueshmërisë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit, bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore dhe të legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, për të siguruar mirëmbajtjen, shërbime riparimi, dhe sigurinë e sistemeve TIK.
- d) të përfshijnë skemën e Ruajtjes së Informacionit (*back-up*), të Vazhdueshmërisë së Punës (*Business Continuity*), të Rikuperimit nga Katastrofa (*disaster recovery*), për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të sistemeve.
- e) të sigurojnë pronësinë e kodeve burimore (*source code*) dhe/ose të drejtën për të blerë kodet burimore.

Pronësia e kodeve burimore, analiza e projektimit, burimi dhe programet e ekzekutueshme të të gjitha sistemeve të aplikimit të zhvilluara do ti kalojnë institucionit pa asnjë kosto shtesë.

### **III. PROCEDURA E MIRATIMIT TË TERMAVE TË REFERENCËS**

9. Projekti i investimit, do t'i nënshtrohet procedurave në vijim:

- a) Fondet për blerjen e pajisjeve elektronike dhe për çdo projekt tjetër që lidhet me TIK, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI), bazuar në pikën 6 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave, nr. 1/1, datë 19.02.2013, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".
- b) Institucioni, i cili kërkon të marrë konfirmimin nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për specifikimet teknike të pajisjeve/sistemeve kompjuterike duhet të dorëzojë pranë AKSHI, një kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin e paraqitur në Anekset 1, 2 ose 3, në varësi të llojit të projektit.
- c) AKSHI e miraton ose refuzon dokumentacionin, me një shpjegim të arsyetuar brenda 20 (njëzet) ditë pune nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit.

- d) Nëse dokumentacioni është ndryshuar pasi është miratuar nga AKSHI, atëherë dokumentacioni do të ri paraqitet për miratim.
- e) Në çdo rast, kur shtesa në projektin fillestar kalon vlerën 20 për qind, të vlerës së përgjithshme të projektit fillestar, atëherë kjo shtesë e re në projekt dërgohet për miratim.
- f) Specifikimet teknike të miratuara nga AKSHI janë detyruese për tu zbatuar nga Njësia e Prokurimeve të Përqendruara dhe nga Institucioni i cili i ka dërguar ato për miratim.


10. Bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, respektivisht:

- a) ANEKSI 1 – Terma reference për Projektet TIK
- b) ANEKSI 2 – Mirëmbajtje për Projektet TIK, hardware dhe software
- c) ANEKSI 3 – Kërkesë për blerjen e pajisjeve hardware TIK

11. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet e përmendura në pikën 4, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në “Fletoren Zyrtare”

**MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE  
TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**



GENC POLLO

NR.PROT.2595  
DATĘ 2.9.2013

PRESIDENCËS  
KUVENDIT  
GJITHË MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE  
TË TJERA QENDRORE

Gjergj LEZHJA

## Sekretari i Përgjithshëm

